

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E ARSIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr. i prokurimit	208 Udheheqesi-25-3443-1-1-1
Nr. i brendshëm	208025016111

Sa i përket tenderit për: “Blerja, furnizimi, montimi dhe instalimi i tabelave te mençura (smartboard) për qëllime arsimore për institucionet e arsimit parauniversitar”.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SOLUTION D SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Ekrem Rexha nr.28

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

038 233 233

038603524

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Driton Sanaja

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

sales@solutiond.net

(Adresa elektronike)

04.08.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për Kontratë: 23.04.2025 Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 01.08.2025 Kërkesës për Rishqyrtim e dt. 24.07.2025 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 30.07.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 17 i RRPP Nr.001/2022
Neni 25 i RRPP Nr.001/2022.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë ishte publikuar me dt. 23.04.2025, kurse hapja e ofertave ishte parashikuar të bëhet me dt. 13.06.2025. Një operator ekonomik kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe pastaj ankesë në OSHP, ndërsa pa vendimit të OSHP-së, AK-ja tani ka publikuar përsëri dosjen e tenderit, ku i ka bërë disa ndryshime estetike, të cilat nuk mund të quhen as ndryshime. Sa për sqarim ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt 05.06.2025 mirëpo që nuk kishim pranuar fare përgjigje nga ana e AK-së.

Tani pas publikimit të dosjes së re, ne përsëri kemi analizuar dosjen e tenderit dhe specifikat teknike të këtij aktiviteti të prokurimit dhe pas analizës që kemi bërë, kemi vërejtur se autoriteti kontraktues ka përgatitur dosjen e tenderit në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, për faktin se janë vendosur disa kërkesa diskriminuese/favorizuese, prandaj për të parandaluar diskriminimin dhe favorizimin

që AK-ja e ka bërë në këtë aktivitet të prokurimit ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim përsëri, me dt.24.07.2025, mirëpo e njëjta na është refuzuar, andaj jemi të detyruar të parashtrojmë këtë ankesë tek OSPH-ja.

Ne edhe një herë po i sqarojmë kërkesat diskriminuese dhe të paqarta të AK-së si më poshtë:

Tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar:

1. *OE duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015.*
2. *OE duhet të jetë i certifikuar me ISO 27001:2022*
3. *Certifikatat e CE dhe RO për eksport në Europë;*

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. *Certifikatë ISO 9001:2015 (origjinal apo kopje e noterizuar, verifikimi online)*
2. *Certifikatë ISO 27001:2022 (origjinal apo kopje e noterizuar, verifikimi online)*
3. *Certifikatat e CE dhe ROHS për eksport në Europë*

Kërkojmë që të largohet në tërësi kërkesa për ISO 27001:2022, sepse e njëjta nuk është fare relevante për këtë aktivitet të prokurimit.

Sa për sqarim ISO e lartcekur ka për qëllim:

Qëllimi i certifikatës ISO 27001:

Të sigurojë mbrojtjen e informacionit nëpërmjet një sistemi të menaxhimit të sigurisë që garanton konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e tij.

Tri shtyllat kryesore të sigurisë së informacionit që mbulon ISO 27001:

- Konfidencialiteti – Vetëm personat e autorizuar kanë qasje në informacion.
- Integriteti – Informacioni është i saktë dhe nuk është manipuluar ose ndryshuar pa autorizim.
- Disponueshmëria – Informacioni është i qasshëm kur nevojitet nga përdoruesit e autorizuar.

Sipas të dhënave të përshkruara më lartë përkatësisht qëllimin e kësaj ISO certifikatë, atëherë kuptohet qartë se ISO e lartcekur është e panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht është jo relevante me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe si e tillë e njëjta duhet të largohet në tërësi nga dosja e tenderit.

Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë sqarim se përse është e nevojshme kjo ISO e kërkuar, mirëpo nëse eventualisht paneli shqyrtues i OSHP-së e sheh të arsyeshme që të mos largohet kërkesa e lartcekur, atëherë ne kërkojmë që e njëjta certifikatë të kërkohet vetëm për prodhuesin, për faktin se kur analizohet qëllimi i kësaj certifikate, atëherë e njëjta duhet të prezantohet vetëm nga prodhuesi sepse është e panevojshme që kompania e cila nuk prodhon pajisjet e kërkuara për këtë aktivitet të jetë e pajisur me këtë certifikatë.

Gjithashtu në kërkesën e lartpërmendur janë specifikuar Certifikatat e CE dhe ROHS për eksport në Europë;

Ne si operator ekonomik vlerësojmë se këto certifikata janë të aplikueshme vetëm për prodhuesit e pajisjeve, dhe jo për ne si operatorët ekonomik të autorizuar në Kosovë. Bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik të Kosovës (Neni 59 dhe Neni 65), prandaj përmes kësaj anese, kërkojmë që të detyroni autoritetin kontraktues që të ndryshoj kërkesën në lidhje me ISO dhe CE me qëllim që dorëzimi i dëshmive të kërkuara si më poshtë:

1. *Dorëzimi i Deklaratës së Konformitetit (nga prodhuesi ose nga partnerë të autorizuar), dhe*
2. *Dorëzimi i Kopjeve të certifikatave të prodhuesit (jo domosdoshmërisht në emrin e kompanisë ofruese)*

Kjo është në përputhje me praktikën e zakonshme në kontratat e furnizimit, ku certifikatat për CE, ROHS dhe ISO janë përgjegjësi e prodhuesit, dhe operatori ekonomik duhet të sigurojë vetëm përputhshmërinë dhe dokumentacionin mbështetës gjatë kontratës.

Andaj kur kemi parasysh faktet e lartcekura kërkojmë që të ndryshohen kërkesat e lartcekura, asipas pretendimit tonë ankimore, pasi që nëse një gjë e tillë nuk ndryshon, kuptohet qartë se ky aktivitet i prokurimit është i destinuar për një OE të vetëm i cili i posedon certifikatat sipas kërkesve të AK-së.

Tek kapaciteti ekonomik dhe financiar është kërkuar *“Kapaciteti ekonomik dhe financiar*

1. *Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues, se qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE gjatë tri viteve për*

Lot I: 5,000,000.00 €.

Lot II: 5,000,000.00 €”.

Kërkesa e lartcekur kërkojmë që të ndryshohet duke e ulur vlerën e qarkullimit në një kufi minimal, me qëllim të hapjes së konkurrencës. Tek neni 8.4 i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, specifikohet si në vijim *“8.4 Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”.*

Në këtë rast me kërkesën e lartcekur nuk i është kushtuar fare rëndësi zhvillimit të OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme sipas dispozitës së nenit të lartcekur. Autoriteti kontraktues ka vendosur si kërkesë vlerën maksimale të lejuar, andaj kërkojmë që të bëhet ndryshimi i kërkesës së lartcekur duke e përcaktuar një vlerë më të ulët të qarkullimit për tri vitet e fundit.

Tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar *“Kapaciteti teknik dhe profesional*

1. *Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë për*

Lot I: 4,000,000.00 €.

Lot II: 4,000,000.00 €”.

Kërkesa e lartcekur është kërkesë diskriminuese dhe ju pamundëson ofertimin kompanive të interesuara për këtë aktivitet të prokurimit. Përkatesisht kërkesa e lartcekur e favorizon një OE të caktuar i cili ka të përfunduara projekte të kësaj natyre, pasi që siç edhe e dijmë projekte të tilla në shtetin tonë janë shumë të rralla dhe vetëm OE të caktuar posedojnë referenca të natyrës së ngjashme në vlerat e kërkuara.

Prandaj kërkojmë nga AK-ja që konform nenit 8.4 Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, ku specifikohet *“8.4 Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”*, të caktohet një vlerë minimale e kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit.

Kjo kërkesë praktikisht e favorizon një kompani të caktuar, ndërsa ju pamundëson ofertimin kompanive vendore të cilët nuk posedojnë referenca të natyrës së ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit. Pra në vend që të ju mundësohet ofertimi kompanive vendore, AK-ja po e bën të kundërtën, duke ju pamundësuar ofertimin me kërkesa diskriminuese.

Tek kapaciteti teknik dhe profesional janë kërkuar kërkesa shumë kufizuese dhe njëkohësisht të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit, andaj të njëjtat do të sqarojmë dhe kundërshtojmë si në vijim:

Tek kërkesa nr.3 e kapacitetit teknik dhe profesional janë kërkuar “3. Dy (2) Ekspert të Pajisjeve të TI-së: të cilët duhet të kenë:

- a. Të përfunduara studimet Universitare Baçelor i Inxhinierisë Kompjuterike ose Baçelor i Shkencave Kompjuterike,
- b. Të ketë përvojë pune se paku 3 vjeçare pas diplomimi”.

Në këtë aktivitet të prokurimit është e panevojshme të kërkohej dy ekspert të pajisjeve pasi që pajisjet siç dihet prodhohen nga prodhuesi, pra pajisjet vijnë të gatshme andaj nuk është e nevojshme që të kërkohej dy ekspert sipas kërkesës së lartcekur.

Kur kemi parasysh faktin e lartcekur dhe nëse eventualisht AK-ja e sheh të arsyeshme që duhet të kërkohej ndonjë ekspert për këtë aktivitet të prokurimit, atëherë kërkojmë që të ndryshohet kërkesa e lartcekur duke e reduktuar numrin e ekspertëve të kërkuar nga dy në një ekspert, pasi që një ekspert është i mjaftueshëm, kur kemi parasysh faktin se pajisjet do të vijnë të gatshme.

Tek kërkesa nr.4 po ashtu janë kërkuar “4 Lot I dhjetë (10) Teknik i TI-së të cilët duhet të kenë:

- a. Kontratat apo kontrata e angazhimit
 - b. Certifikimet për SMART BOARD
- Llot II dhjetë (10) Teknik i TI-së të cilët duhet të kenë:
- a. Kontratat apo kontrata e angazhimit
 - b. Certifikimet për SMART BOARD”.

Numri i teknikëve të kërkuar është numër kufizues, prandaj kjo kërkesë e favorizon një OE të caktuar e cila e posedon numrin e kërkuar të teknikëve. Ne mendojmë që kjo kërkesë duhet të ndryshohet sepse e njëjta është kërkesë diskriminuese dhe si e tillë kërkojmë që të reduktohet numri i teknikëve në minimumi 8-10 teknikë për të dy lotet, sepse ky numër është i mjaftueshëm për të realizuar këtë projekt.

Nëse eventualisht nuk ndryshohet kërkesa e lartcekur, atëherë kuptohet qartë se ky aktivitet i prokurimit është i destinuar për një OE të caktuar i cili posedon stafin e kërkuar nga ana e AK-së. Me këto kërkesa jo vetëm që po ju pamundësohet OE të themeluar rishtazi, njëkohësisht po ju pamundësohet ofertimi edhe kompanive me shumë përvojë në këtë fushë të prokurimit.

Tek kërkesa 5 është kërkuar “5. Një (1) Analist të Projektit, i cili duhet të kenë:

- a. Të përfunduara studimet Universitare Baçelor i Inxhinierisë Kompjuterike ose Baçelor i Shkencave Kompjuterike,
- b. Të ketë përvojë pune se paku 1 vjeçare pas diplomimi”.

Kërkesa e lartcekur është e panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit, andaj e njëjta duhet të largohet në tërësi nga dosja e tenderit. Përderisa në dosje të tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar një ekspert i teknologjisë dhe një menaxher i projektit i diplomuar në

Inxhinieri kompjuterike, atëherë vlerësojmë se detyrat e një analisti të projektit do të kryhen nga eksperti dhe menaxheri i projektit.

Kur kemi parasysh faktet e lartcekura kuptohet qartë se kërkesa për një analist të projektit është kërkesë e panevojshme dhe diskriminuese për OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit. Njëkohësisht kërkesa e lartcekur favorizon një kompani të caktuar e cila e posedon analistin e projektit sipas kërkesës së lartcekur, prandaj me qëllim të hapjes së konkurrencës kërkojmë që të largohet në tërësi kjo kërkesë nga dosja e tenderit.

Pretendimet tek specifika teknike:

Pretendimi 1:

Tek specifikat teknike, shihen qartë disa kontradikta ndërmjet rreshtave të specifikuara nga AK-ja. Si shembull në një rresht specifikohet "Infrared (InGlass Touch)", ndërsa më vonë përshkruhet vetëm "IR". Kështu siç janë hartuar specifikat teknike krijohen paqartësi dhe njëkohësisht OE mund të eliminohen nga aktiviteti i prokurimit për kërkesa të pa sqaruara dhe kontradiktore njëra me tjetrën. Kërkojmë që të bëhet ndryshimi i kërkesës së lartcekur dhe të lejohet të prezantohet produkti edhe me "IR", sepse pak prodhues e ofrojnë teknologjinë e kërkuar nga AK-ja dhe njëkohësisht e njëjta nuk ka benefite të konsiderueshme kërkesa për teknologjinë me InGlass Touch.

Teknologjia "InGlass" është një teknologji e patentuar dhe markë tregtare e regjistruar nga FlatFrog Laboratories, zakonisht e përdorur në partneritet me SMART Technologies. Rrjedhimisht, këtë teknologji e ofrojnë shumë pak prodhues, çka krijon një avantazh të padrejtë për disa ofertues dhe nuk përmbush parimin e barazisë në prokurim.

Duhet theksuar fakti se AK-ja në dosje të tenderit përkatësisht tek neni 4.1, Variantet nuk janë autorizuar/lejuar. Ndërsa me sqarime AK-ja e ka sqaruar se lejohet të prezantohen produktet ekuivalente. Në këtë rast kemi të bëjmë me mospërputhje në mes të dosjes së tenderit dhe sqarimeve të dhëna nga AK-ja, prandaj kërkojmë që të lejohen variantet me qëllim të hapjes së konkurrencës sepse në këtë rast po diskriminohen kompani të interesuara dhe po favorizohet një prodhues i caktuar.

Pretendimi 2:

Kur analizohen specififikimet teknike të përcaktuara nga AK-ja, ekziston një kontradiktë e qartë në lidhje me specififikimet e altoparlantëve të pajisjes, për faktin se tek **Feature** kërkohet: "Speaker: 20W, 2CH" – që nënkupton sistem me 2 speaker me fuqi totale 20W për speaker.

Ndërsa tek Speaker, specifikohet 4x10W, që nënkupton 4 speaker me fuqi totale 40W.

Kjo mospërputhje krijon paqartësi për operatorët ekonomikë, pasi që nuk është e qartë se cila është kërkesa reale – një sistem me 2 altoparlantë me fuqi 20W secili, apo një sistem me 4 altoparlantë me fuqi secili nga 10W. Kjo kontradiktë mund të sjellë interpretim subjektiv në vlerësimin teknik të ofertave dhe rrezik për diskualifikim të pajustifikuar në bazë të njërit prej specififikimeve.

Kërkojmë që autoriteti kontraktues të qartësojë specifikat teknike për speaker, duke përcaktuar në mënyrë të qartë sistemin e kërkuar në vlerë totale të fuqisë në 2 x20 Watt pasi që në këtë mënyrë OE të cilët ofertojnë me specifika të ndryshme eliminohen nga aktiviteti i prokurimit.

Pretendimi 3:

Po ashtu tek specifikat teknike është specifikuar Pesha: **59.3 kg**.

Kështu siç është përcaktuar pesha e pajisjes shihet dhe vërtetohet qartë se AK-ja këtë aktivitet të prokurimit e ka përgatitur për një OE të caktuar, pasi që është pothuajse e pamundur që të gjithë OE të prezantojnë pajisjen me këtë peshë. Pësja e kërkuar prej **59.3 kg**, është e paqartë se a bëhet fjalë për peshën NETO apo BRUTO. Kështu siç është specifikuar kërkesa, krijohet paqartësi tek operatorët ekonomik të interesuar për ofertim, pasi që nëse një OE oferton me peshë bruto sipas kërkesë apo me peshë neto, atëherë AK-ja mund ta eliminojë OE me cilëndo peshë (neto/bruto) që aplikon. Prandaj një gjë e tillë duhet të specifikohet saktë në kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht tek specifikat teknike, sepse në momentin që OE ofertojnë me produktin me peshë 59.3kg bruto ose neto, atëherë i njëjti mund të eliminohet shumë lehtë nga konkurrenca, prandaj edhe AK-ja duhet ta specifikojë një gjë të tillë në dosje të tenderit.

Prandaj me qëllim të hapjes së konkurrencës, ne kërkojmë që të lejohet një tolerancë teknike prej $\pm 20\%$, ndërsa nëse eventualisht nuk bëhet ndryshimi i kësaj kërkesë, **atëherë këtu kuptohet qartë se AK-ja po e përcakton fituesin e këtij aktiviteti të prokurimit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit.**

Ne me dt.30.07.2025 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, mirëpo që i njëjti vendim nuk përmban asnjë arsytim konkret dhe të bazuar në ndonjë dispozitë ligjore.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është arsyetuar si në vijim:

Ne si Mbrojtari e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, i kemi analizuar dhe vëmendje të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ju si Operator Ekonomik.

Konsiderojmë se të gjitha pretendimet tuaja janë plotësisht të pabazura, janë bërë rregullimet në Korigjimin e procedurës lidhur me kriteret e kërkuara në dosje të tenderit. Ndërsa, sa i përket specifikacionit teknik, i kemi rregulluar pas vendimit të OSHP-së dhe nuk ka më ndryshime.

Arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, pasi që e njëjta nuk ka dhënë përgjigje konkrete në lidhje me pretendimet tona ankimore, mirëpo ka dhënë një arsytim të përgjithshëm se kinse janë bërë ndryshimet sipas vendimit të OSHP-së, mirëpo që një gjë e tillë është e paqëndrueshme.

Kur analizohet dosja e tenderit, shihet qartë se AK-ja nuk ka bërë ndryshimet sipas kërkesave tona, mirëpo vetëm është munduar të bëjë kinse ndryshime duke mos përmendur emra, por përsëri ja ka përshtatur specifikat teknike një prodhuesi të caktuar.

Përderisa autoriteti kontraktues nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet tona ankimore, e njëjta ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, përkatësisht në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së paragrafi 9 ku specifikohet qartë "9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim."

Përderisa ne nuk kemi marrë përgjigje konkrete në pretendimet tona ankimore, atëherë kërkojmë nga OSHP, që të analizojë në detaje ankesën tonë dhe të nxjerrë një vendim meritore, pasi që në këtë rast po na pamundësohet ofertimi neve si kompani e interesuar.

Kërkojmë që të bëhen këto ndryshime dhe të hapet konkurrenca sepse me hapje të konkurrencës kemi trajtim më të barabartë të kompanive dhe normalisht që kur ka konkurrencë edhe çmimi

ofertues orientohet në atë drejtim që të vjen në shprehje edhe qëllimi i LPP- ruajtja dhe shfrytëzimi më racional i parasë publike sipas nenit 1 dhe 6 të LPP-së.

Dosja e përgatitur në këtë mënyrë, bie ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6.

Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Me këto kërkesa dhe me këtë dosje, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur të operatorëve ekonomik që merren me punë dhe që janë profesional në këtë lëmi.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton nuk është përpiluar dosja e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është marr parasysh as neni 17.17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që **nuk: Kufizon konkurrencën** në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”.

Neni 25.6 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik e parasheh qartë “Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim **do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale** për objektin e kontratës në fjalë. Në këtë tender kërkesat dhe specifikat teknike të përcaktuara në dosje të tenderit nuk janë proporcionale me objektin e kontratës dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe janë kufizuese.

Kërkesat/specifikimet teknike që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit edhe shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”.

Kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e lartcekura dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit të OE “**SOLUTION D**” SH.P.K.

NDRYSHOHEN kërkesat, që u çekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së,

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, dhe sinjalizimin për të gjitha shkeljet ligjore që konsiderojmë se kanë ndodhur në këtë procedurë tenderuese.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat ligjore në institucionet tjera kompetente.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.